



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax:042 232491

Nr. 1011/9 Prot.

Tiranë, më 09.03.2017

V E N D I M

Nr. 17, Datë 09.03.2017

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
DEGËN E DOGANËS BERAT "MBI ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT
DOGANOR NË PROCESIN E REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE
DOGANORE DHE VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË EKONOMIKO-
FINANCIARE."

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standarteve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të Ligjit nr.154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e legjislacionit doganor në procesin e realizimit të të ardhurave doganore dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të ushtruar në Degën e Doganës Berat, për periudhën 01.01.2014-30.06.2016".

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i ushtruar rezultoi se, nuk është zbatuar plotësisht pika nr. B.1, B.2 dhe B.3 e rekomadimeve, dërguar me shkresën nr. 575/8 të Kryetarit të KLSH-së datë 15.09.2014 me lëndë “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet” protokolluar në DDB me shkresën nr.1871, datë 22.09.2014 në lidhje me Masat Administrative që lidhen me penalizmin e subjekteve të konstatuar në shkelje doganore për 3 operatorët tregtarë, si dhe nuk është zbatuar plotësisht pika C.a, C.b e rekomadimeve të lëna që lidhen me këtë Raport Përfundimtar në lidhje me Masat Shpërblim Dëmi kërkuar për interpretim Drejtorisë së Vlerës pranë Departamentit Teknik në DPD me shkresën nr. 1438, datë 30.10.2014 për tre subjekte në shumën 1,639,225 lekë *(trajtuar më hollësisht në faqet nr.16-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 1.1. Dega e Doganës Berat të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e plotë të rekomandimit të lënë në auditimin e mëparshëm dërguar me shkresën nr. 575/8 të Kryetarit të KLSH-së datë 15.09.2014 me lëndë “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet” protokolluar në DDB me shkresën nr.1871 datë 22.09.2014 në lidhje me zbatimin e Masave Administrative sipas pikave B.1, B.2, dhe B.3 për tre operatorë tregtarë.

Rekomandimi 1.2. Dega e Doganës Berat ti rikërkojë Drejtorisë së Vlerës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave përgjigje të detyrueshme në lidhje me interpretimin ligjor për shkeljet e konstatuara në lidhje me tre operatorë tregtarë në shumën 1,639,225 lekë, dërguar për interpretim me shkresën nr. 1438, datë 30.10.2014 nga DDB dhe që lidhen me pikën C.a, C.b të rekomadimeve të lëna në auditimin e mëparshëm dërguar me shkresën nr. 575/8 prot KLSH, datë 15.09.2014 me lëndë “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet” protokolluar në DDB me shkresën nr.1871 datë 22.09.2014.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i Sektorit të Mbledhjes së Borxhit, u konstatua se detyrimet e pa arkëtuara në fund të vitit 2014 janë në vlerën 623,083 mijë lekë. Për vitin 2015 detyrimet e e borxhit të pa arkëtuara në fund të vitit janë në shumën 653,190 mijë lekë. Në fund të 6 mujorit të parë të vitit 2016, vlera totale borxhit është në shumën 643,274 mijë lekë, nga të cilat shuma 147,151 mijë detyrime doganore, shuma 140,280 mijë lekë si kamatvonesa dhe shuma 355,841 mijë si gjoba doganore. Në fund të kësaj periudhe kemi një pakësim të numrit të debitorëve të mbartur nga periudhat e mëparshme, një tendencë të borxhit në ulje, por ka një nivel të ulët arkëtimi të debitorëve të mbartur. *(trajtuar me hollësisht ne faqet nr.103-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 2.1 Autoriteti doganor kompetent Dega Doganore Berat, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganore të marrin masa konkrete të menjëhershme, për të zgjidhur në rrugë ligjore ekzekutimin dhe rikuperimin e borxhit doganor gjëndje më datë 31.06.2016 në shumën 643,274 mijë lekë, nga të cilat shuma prej 147,151 mijë lekë detyrime doganore, 140,280 mijë lekë në formën e kamat vonesave dhe shuma prej

355,841 mijë lekë gjoba doganore në bashkëpunim me të gjitha strukturat e specializuara të përcaktuara në Udhëzimin nr. 6 datë 23.07.2013 “Mbi zbatimin praktik të kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit” nëpërmjet një programi të posacëm, për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor për të gjithë ato subjekte që rezultojnë debitorë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i procedurave të vlerësimit doganor e klasifikimit tarifor të mallrave rezultoi se, nga personeli përpunues është pranuar vlera e transaksionit për vlerën e transportit për kushtet e lëvrimin CIP, DAP, CIF dhe EXW, ndonëse dokumentacioni bashkëlidhur praktikës nuk justifikon këtë metodë vlerësimi në mospërputhje me shpjegimet dhe përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 25 të Ministrisë të Financave dhe pikës 1 dhe 2 të nenit 37 të Kodit Doganor duke krijuar të ardhura të munguara doganore për 16 subjekte në shumën 2,789,337 lekë (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 31-76 dhe anekset nr. 15,16,17,18,19,29 dhe nr. 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 3.1. Dega Doganore Berat në bashkëpunim me Drejtorinë e Vlerës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të marrë masa konkrete, për rrillogaritjen e detyrimeve doganore të transportit për mallra të kapitullit 87 të lëvruar sipas kushtit EXW për 25 raste në përputhje me shpjegimet dhe përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 25 të Ministrisë të Financave dhe pikës 1 dhe 2 të nenit 37 të Kodit Doganor trajtuar në aneksin nr. 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, por duke mos u kufizuar vetëm në sa është konstatuar në këtë auditim.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi ka rezultuar se gjatë konstatimit të shkeljeve doganore që cilësohen si kontrabandë, referuar pjesës së VIII të Kodit Doganor dhe neneve 85, 94 pika 1 dhe 1/b të ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në RSH” gjatë nxjerrjes së vendimeve administrative nuk është kërkuar sekuestrimi dhe konfiskimi i mallrave të gjetur në shkelje, për 4 raste ku është dalë me vendim administrativ si dhe nuk është kërkuar në 4 raste zbatimi i plotë përcaktimeve ligjore të pikës 1 dhe 2.c të nenit 93 të ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në RSH” (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 104-120 dhe aneksin 58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 4.1. Dega Doganore Berat, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësinë për vendimet administrative të përcaktuara në aneksin nr. 58 dhe gjatë hartimit të akteve të konstatimit, nxjerrjes së vendimeve doganore për kontabilizimin e detyrimeve doganore të papaguara, të marrë në konsideratë të plotë përcaktimet e nenit 281 pika 1,a, 291 dhe 283 “sekuestrimi i objekteve të kontrabandës” të ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimin nr. 4 datë 30.09.1999, “Mbi Zbatimin e Dispozitave të parashikuara në pjesën VIII të Kodit Doganor” dhe nenin 85, 94 pika 1 dhe 1B të ligjit nr.61/2012 “Për Akcizat në RSH” (*për sa trajtuar faqet nr. 104-120 dhe aneksin 58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 4.2. Dega Doganore Berat në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të riuhtrojë kontroll pranë operatoreve tregtarë të cilët nuk kanë lejuar ushtrimin e kontrollit nga Autoritetet Doganore dhe të veprjës deri në përmbushjen e plotë të përcaktimeve ligjore sipas shpjegimeve të pikës 2/c të nenit 93 ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në RSH” (trajtuar më hollësisht në faqen 118 dhe aneksin nr. 58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi ka rezultuar se, gjatë konstatimit të shkeljeve doganore në fushën e akcizës, në rastet kur janë evidentuar diferenca në mungesë të mallrave bitum dhe solar në magazinat fiskale të depozituesve të miratuar të subjekteve “■” me nipt ■ dhe “■” me nipt ■ që operojnë sipas ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, janë llogaritur detyrimet doganore të akcizës nxjerrë sipas vendimeve administrative respektive, por nuk është kërkuar llogaritja dhe pagimi i detyrimit mbi tvsh- në shumën 28,228,199 lekë si dhe detyrimet e tjera respektive tatimore që lidhen me tatimin mbi fitimin gjoba dhe sanksione sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7928 datë 27.04.1995 për “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, ndryshuar me ligjin nr. 92 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe përcaktimeve të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar.(trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 34 dhe faqet nr. 104-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 5.1. Dega Doganore Berat në bashkëpunim me Departamentin Operativ-Hetimor dhe Departamentin e Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për sasinë e mallrave të akcizës të gjetur në mungesë në magazinat fiskale të subjekteve me status depozitues të miratuar “■” me nipt ■ dhe “■” me nipt ■ të njoftojë në mënyrë të detyrueshme Drejtorinë e Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për vlerën dhe sasinë e mallit të akcizës të gjetur në mungesë dhe të kërkojë të përlllogarisin detyrimin e Tvsh-së në shumën 28,228,199 lekë si dhe detyrimet e tjera tatimore respektive sipas përcaktimeve të Legjislacionit Tatimor në fuqi në RSH me qëllim kërkimin e arkëtimit të detyrimeve tatimore dhe dokumentimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë penale për veprimet e kryera nga operatorët tregtarë “BP 2014” dhe “Enarvi”.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i regjistrave të hyrjes e daljes së mjeteve në territorin e Degës Doganore Berat, të administruar nga shërbimi i ruajtjes fizike të kësaj dege, si dhe regjistrat (import-export) të administruara nga personeli doganor nuk rezultojnë të rakorduara të ardhurat dytësore të raportuara në pasqyrat financiare të dorëzuara me shkresat nr. 52, datë 09.01.2015 dhe nr. 30, datë 11.01.2016 pranë DPD. U konstatua një diferencë në shumën 8,010,800 lekë për periudhën 01.01.2014-31.12.2015 duke reflektuar shkelje të kërkesave të Udhëzimit nr. 432, datë 28.06.2006 të MF “Për krijimin e të ardhurave dytësore që krijojnë Institucionet Buxhetore”, si dhe shkresës nr. 13119, datë 02.11.2006, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Mbi caktimin e

tarifave të të ardhurave dytësore në administratën doganore”. (trajtuar më hollësisht në faqet nr. 20-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 6.1 Dega e Doganës Berat të marrë masa të menjëhershme për rakordimin evidentimin, përlllogaritjen dhe përcaktimin e saktë të vlerës së tarifave të parkingut dhe peshimit dhe arkëtimin e menjëhershëm të shumës së përlllogaritur që do të rezultojë në mungesë nga zëri i të ardhurave dytësore “Parkingu Doganor” për praktikën doganore të zhdoganimit import-eksport të kryera për periudhën 01.01.2014-31.12.2015 periudhë për të cilën janë dorëzuar dhe pasqyrat financiare pranë DPD, në shumën prej 8,010,800 lekë. Për pasqyrat financiare të vitit 2016, përpara dorëzimit të tyre pranë DPD të rakordohet, evidentohet dhe përcaktohet, saktë vlera e tarifave të parkingut dhe peshimit që duhet paguar dhe të ndiqet arkëtimi i menjëhershëm i shumës së përlllogaritur për praktikën doganore të zhdoganimit import-eksport të kryera për periudhën 01.01.2016-30.06.2016 nga Dega Doganore Berat.

Menjëherë

7 Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve që kanë perfituar përjashtim nga tarifa doganore dhe detyrimi i tvsh-së, nëpërmjet Autorizimeve të Përjashtimit bazuar në ligjin nr. 92/2014 datë 24/07/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, nenit 56 pika 38 e VKM se nr. 953, datë 29.12.2014, neni 8 pika 1 gërma B dhe të autorizuar me kod shtesë IPO, rezultoi se vlerat e mallrave për këto investime të financuara nga projekte me hua shtetërore, janë të larta në krahasim me transaksionet e kryera për të njëjtët kode tariforë pranë Degës Doganore Berat dhe gjatë deklarimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, këto transaksione ngarkohen si vlera fillestare investimi nga këta subjekte (trajtuar më hollësisht në faqet nr. 31-76 dhe aneksin nr. 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 7.1. Dega Doganore Berat në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të informojë në mënyrë të detyrueshme Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat verifikimin e transaksioneve të kryera nga kompanitë importuese dhe në përfundim të rezultateve të kryera në rast se verifikimet e transaksioneve të kryera nuk do të përputhen me deklaratimet e kryera nga këta operatorë tregtarë të ndërmerren sanksionet respektive bazuar në ligjin nr. 8449, datë. 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" dhe në Legjislacionin Tatimor në RSH .

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi. Konstatohet se operatorë ekonomik që operojnë në fushën e akcizës me status depozitues të miratuar nuk kanë kryer kalibrime për të gjitha depozitat e silloset me kapacitet mbajtës mbi 10 hektolitra si dhe nuk disponojnë kalimatësat në hyrje dhe dalje të produktit në depozita si dhe në pikën e shitjes, në kundërshtim me procedurën ligjore të shprehur në pikën 3/c, neni 20, ligji nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSH”, të përcaktuara si “Detyrime të Depozituesit të Miratuar” për një mbikëqyrje sa më të plotë të magazinave fiskale. (trajtuar më hollësisht në faqet nr. 121-134, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 8.1. Dega Doganore Berat në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me qëllim rregullimin e situatës së krijuar në zbatim të gërmës (c) të pikës 3, neni 20 të ligjit nr.61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSH”, të detyrojë depozituesit e miratuar “të përmbushin të gjitha kërkesat e vendosura nga administrata doganore për të mundësuar mbikëqyrjen e magazinës fiskale” duke kërkuar kalibrimin e gjithë depozitave, enëve dhe sillosëve si dhe kalimatësave në hyrje dhe dalje të produktit ne depozita si dhe në pikën e shitjes dhe të aplikojë sanksione administrative sipas neni 85, Kreu “Shkeljet në fushën e akcizës dhe sanksionet”, pika 1.a “Kundërvajtje Administrative”, neni 96.1, pika 1 deri në revokimin e autorizimeve të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për këta subjekte me status depozitues të miratuar

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi. Konstatohet se 7 (shtatë) operatorë ekonomikë që operojnë me aktivitet në fushën e regjimeve ekonomike doganore gjatë mbylljes së afateve të autorizimeve kanë diferenca për treguesin “vlerë malli”, në shumën 19,600,000 lekë dhe sasinë prej 14,756 palë/copë duke kryer veprime jo në përputhje me nenin 139 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimin nr. 1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”. Nga sektori i regjimeve dhe akcizës nuk janë kryer verifikime kontabël për këto raste pranë selive të operatorëve ekonomikë me qëllim saktësimin e treguesve vlerë malli dhe copë/palë. (trajtuar më hollësisht në faqet nr. 77-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 9.1. Dega Doganore Berat në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me qëllim rregullimin e situatës së krijuar për parregullësitë dhe diferencat e konstatuara nga krahasimi i dokumentacionit të mbikëqyrjes e të mbylljes së regjimit (Model3), të ngrejë grup pune të përbashkët me qëllim saktësimin e verifikimeve të dokumentacionit kontabël pranë selive të operatorëve tregëtarë për shumën 19,600,000 lekë dhe sasinë prej 14,756 palë/copë pranë selive të këtyre 7 (shtatë) operatorëve ekonomike në zbatim të nenit 139 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimi nr. 1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi. Konstatohet se, për importet e mjeteve të rënda motorike si koka tërheqëse dhe kamiona nuk ka të dhëna të diponueshme të publikuara zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe vlerësimi doganor është kryer me vlera më të ulëta se vlerat e publikuara në ofertat e rrjeteve të njohura “AS 24” dhe “C SM”, duke krijuar të ardhura të munguara doganore (trajtuar më hollësisht në faqet nr. 31-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 10. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kërkojë nga Dega Doganore Berat dhe gjithë Degët e Doganore në RSH që gjatë vlerësimit doganor të mallrave të natyrës mjete motorike ose mjete transporti të natyrës koka tërheqëse dhe kamiona për të cilat nuk ka të dhëna të diponueshme të publikuara zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si burim informacioni për vlerësimin doganor të mallit të kërkojë burimet e përcaktuara në pikat 10.1 deri në pikën 10.7 “oferta dhe publikimi nga

interneti” sipas pikës 3 të Sesioni II:të Udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007 të MF “Mbi shqyrtimin e vlerës doganore” duke marrë ne konsideratë cmimet e mallrave të ngjashëm pranë rrjeteve të njohur të shitjes “AS 24” dhe “C SM” etj

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Dega e Doganës Berat të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë të menjëhershme ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për arkëtimin dhe shpërblimin e **dëmit në Buxhetin e Shtetit në Shumën 108,570 mijë lekë**, në mënyrë analitike nga pika 1-6 edhe sipas anekseve nr. 1 deri nr. 58:

1. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të marra për shkeljet në fushën doganore rezultuan vendimeve administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, ligjit nr 61 /2012 “Për Akcizat në RSH”, Ligjit. 92 datë 24.07.2014 “Për Tatim mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, VKM nr. 559 datë 24.08.2006 “Për Skemën e shtyrjes së TVSH-së” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 1 datë 26.09.2006 të DPD, në shumën totale 41,844 mijë lekë, nga të cilat 40,913 mijë lekë i përkasin vitit 2014, 820 mijë i përkasin vitit 2015, dhe 110 mijë për periudhën e gjashtëmujorit të I të vitit 2016,(*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 104-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Rekomandimi 1.1. Dega Doganore Berat të kërkojë ndryshimin ose revokimin në rrugë ligjore për vendime administrative në shumën **13,616 mijë lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim nxjerrjen dhe arkëtimin e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore nga 16 operatorë tregëtarë bazuar në ligjin nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjin nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSH” i ndryshuar, sipas aneksit nr. 33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më 31.05.2017

2. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit për procedurat e sistemit të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifor të mallrave rezultuan veprime të kryera jo në përputhje me rregullat bazë të Nomenklaturës së Harmonizuar të Mallrave në RSH të dalë me ligjin nr. 9461 datë 21.12.2005, veprime jo në përputhje me nenet 34-37 të KD dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” shpjegimeve dhe përcaktimeve të përcaktuara në kërkesat e Shtojcës (Aneksit) 4 të Protokollit të Origjinës si dhe nenit 22.4 të Udhërrëfyesit “Mbi rregullat e Origjinës Preferenciale.sipas MTL”, me një efekt në shumën 56,538, 882 lekë nga të cilat shuma prej 21,775,137 lekë, për vitin 2014, shuma prej 21,557,803 lekë për vitin 2015 dhe shuma prej 13,205,060 lekë për gjashtëmujorin e I të vitit 2016 trajtuar në total në 695 raste (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 32-74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 2.1. Dega Doganore Berat të nxjerrë dhe arkëtojë detyrimet doganore dhe gjobat doganore në shumën **56,538 mijë lekë** nga të cilat shuma prej 21,775,137 lekë për vitin 2014, shuma prej 21,557,803 lekë për vitin 2015 dhe shuma prej 13,205,060 lekë për gjashtëmujorin e I të vitit 2016 të ndara sipas zërave detyrim doganor i rivlerësuar për tu paguar në shumën 45,090,310 lekë dhe gjoba dhe sanksione doganore për tu paguar në shumën 11,448,572 lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim arkëtimin e shumës së nxjerrë për 695 raste sipas aneksit nr. 1-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Deri më 31.05.2017

3. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit për procedurat e doganore gjatë mbikëqyrjes së regjimeve ekonomike rezultuan veprime që kanë sjelle pasoja në keqadministrim të regjimeve të përpunimit aktiv, shkelje të afateve të mbylljes së autorizimeve, autorizime doganore jo në përputhje me kërkesat e pikës 3.1, të VKM nr.180, datë 13.02.2013, Ligjit. 92 datë 24.07.2014 “Për Tatim mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, VKM nr.559 datë 24.08.2006 ligji nr.8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH”, dhe veprime jo në përputhje me nenin 29, 31, 32, 87, 122, 204, 216 të Kodit Doganor ,pikës 38, 40, 44, 46, 50/2/3, 51/1/2/3 dhe 142 të VKM nr. 205 datë ‘Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor’ dhe VKM nr. 547 datë 01.05.08 që lidhen me veprimtarinë e përfaqësuesve doganorë për periudhën e juridiksionit të auditimit në shumën 18,291 mijë lekë, (trajtuar më hollësisht në faqet nr.74-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 3.1. Dega Doganore Berat të nxjerrë dhe të ndjekë arkëtimin e detyrimeve doganore dhe sanksioneve doganore në shumën **18,291 mijë lekë** nga të cilat shuma prej 10,371 mijë lekë për për subjektin “**████**” me Nipt **████**, për të cilin nuk është nxjerrë vendim administrativ dhe shuma tjetër prej 7,919 mijë lekë nga operatorë të tjerë tregtarë të konstatuara në formën detyrimeve doganore, interesa kompensues dhe gjoba doganore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, me qëllim arkëtimin e detyrimeve dhe sanksioneve doganore sipas aneksit nr. 31-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më 31.05.2017

4. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit për procedurat e doganore që lidhen me pagesën e rentës minerare u konstatuan veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, VKM nr.7, datë 01.01.2012 “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentimit të nevojshëm për arkëtimin e rentës minerare”, si dhe shkresës së MF nr.16365, datë 17.10.2012 “Miratimi i vlerave referuese sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale nga Komisioni Ad-Hoc mbi rentën minerare” me pasojë mungesë të ardhurash në shumën prej 10,315 mijë lekë. (trajtuar më hollësisht në faqet nr. 135-136, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 4.1. Dega Doganore Berat të nxjerrë dhe të ndjekë arkëtimin e shumës së detyrimit të rentës minerare në shumën prej **10,315 mijë lekë** nga 20 subjekte, sipas

anekseve nr.36-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim arkëtimin e shumës së taksës kombëtare të rentës minerare bazuar në legjislacionin në fuqi në RSH.

Deri më 31.05.2017

5. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi u konstatua mungesë dhe mosrakordim të ardhurash dytësore, nga të cilat për vitin 2014 shuma prej 5,326 mijë lekë, për vitin 2014, shuma prej 2,684 mijë lekë për vitin 2015 të nxjerra sipas rakordimit me pasqyrat financiare të protokolluara me shkresat nr. 52 datë 09.01.2015 dhe nr. 30 datë 11.01.2016 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave duke kryer veprime jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 432, datë 28.06.2006 të MF “Për krijimin e të ardhurave dytësore që krijojnë institucionet buxhetore”, si dhe shkresës nr. 13119, datë 02.11.2006, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Mbi caktimin e tarifave të të ardhurave dytësore në Administratën Doganore” në shumën totale 8,010 mijë lekë. (trajtuar më hollësisht në faqet nr. 21-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 5.1. Drejtoria e Auditit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në bashkëpunim me Degën Doganore Berat të hartojnë një program kontrolli të menjëhershëm me qëllim rakordimin, saktësimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e të ardhurave dytësore në shumën **8,010 mijë lekë**, për periudhën e vitit 2014, 2015 me qëllim arkëtimin e të ardhurave dytësore të munguara.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit për procedurat e doganore të subjekteve që operojnë sipas Ligjit nr. 61 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSH” u konstatuan veprime të kryera jo në përputhje me germën (c) të pikës 3, neni 20 dhe 85 të ligjit nr. 61 datë 24.05.2012 për “Akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe veprime jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr.71/2014 të ndryshuar dhe ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, neni 12, pika (2), shkronja (a) “Inspektorati shtetëror përgjegjës ka të drejtë dhe përgjigjet për kontrollin e zbatimit të normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, miratimin e kartave teknologjike të impianteve dhe instalimeve përkatëse” për 6 raste subjektesh në shumën 1,800 mijë lekë (trajtuar më hollësisht në faqet nr. 121-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 6.1 Dega Doganore Berat të nxjerrë dhe arkëtojë në rrugë ligjore gjobat doganore të akcizës në shumën prej **1,800 mijë lekë** për 6 subjekte që operojnë sipas ligjit nr. 61 datë 24.05.2012 për “Akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, sipas aneksit nr. 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim arkëtimin e shumës së rekomanduar.

Deri më 31.05.2017

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë: Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganore Berat që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1 germa “b” dhe “c” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje shumë të rënda, të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

I.a. Neni 58 germa “c-ç”, nga “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” deri në “largim nga shërbimi civil” për nëpunësit civil, si më poshtë:

1. Për z. Dh.Xh., me detyrë doganier i sektorit të klasifikimit, vlerësimit dhe kontrollit fizik.

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2 prot DPD, datë 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar konkretisht:

-për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave të për të cilat dalin të dhëna të përditësuara të bursës nga Departamenti Teknik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me keq klasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të KD;

-jo në përmbushje me Nenin 5 “Produkte tërësisht të përfutuara” pika (h) “artikujt e përdorur, të mbledhur atje, që përshtaten vetëm për mbulimin e lëndëve të para, duke përfshirë gomat e përdorura të përshtatshme vetëm për ritrajtim ose që përdoren si mbetje”, të Udhërfyesit sipas Ligjit Nr. 9590, datë 27.07.2006 për ratifikimin e MSA. me shpjegimet dhe përcaktimet e nenit 23 të Kodit Doganor “E drejta e Kontrollit”, të nenit 93 të Kodit Doganor “Verifikimi i Deklaratës”, pikës 2 të nenit 87 të Kodit Doganor “Deklarata me Shkrim”, pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 71 të Kodit Doganor “Kontrolli i mallrave dhe mjeteve”, pikës 142.2 sipas shpjegimeve të Seksionit 4 “Dokumentacionit që shoqëron Deklaratën Doganore” të Titullit 10 “Deklarata Doganore” të VKM nr. 205 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” si dhe nuk është kërkuar pranë Drejtorisë së Origjinës në Departamentin Teknik procedura e verifikimit të dokumentit Deklaratë Faturë ose Dokumentit MSABE sipas rasteve të trajtuar në këtë raport përfundimtar auditimit

2. Për z. Gj.C., me detyrë ish specialist i kontrollit pas zhdoganimit, me detyrë jurist dhe specialist borxhi aktualisht specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave
-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2 prot DPD, datë 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar,
-për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore dhe akte konstatimi të cilat nuk janë përpiluar në përputhje me legjislacionin doganor dhe raste të klasifikimeve të gabuara tariforë të trajtuar jo në përputhje me legjislacionin me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2, 285, 286 dhe 287 të Kodit Doganor

3. Për z. F.D., me detyrë doganier peshore pikë kontrolli
-duke kryer veprime jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 432, datë 28.06.2006 të MF “*Për krijimin e të ardhurave dytësore që krijojnë Institucionet Buxhetore*”, si dhe shkresës nr. 13119, datë 02.11.2006, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “*Mbi caktimin e tarifave të të ardhurave dytësore në Administratën Doganore*, shkresa nr.18029, datë 07.11.2011 “Rregullore e brendshme e degëve doganore dhe drejtorive rajonale”, neni 15 “sektori operacional”, pika nr. 5 “*Detyrat funksionale për doganierin e peshores dhe pikë kontrolli*”, paragrafi “*Monitoron hyrjen dhe daljen e mjeteve nga parkingu, duke arkëtuar tarifën përkatëse, bazuar në urdhër çlirim*”; si dhe nga ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, Udhëzimi MF nr. 432, datë 28.06.200 “*Për nxjerrjen e të ardhurave dytësore*”
-për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore*”, nxjerrë për këtë qëllim që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave të për të cilat dalin të dhëna të përditësuara të bursës nga Departamenti Teknik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave
-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr. 19095/2 prot DPD, datë 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”.

I.b. Neni 58 germa “a-c”, nga “vërejtje” dhe “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”
për nëpunësit civil, si më poshtë:

4. Për z. A.U., me detyrë doganier i sektorit të regjimeve dhe akcizës.
-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2 prot DPD, datë

12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 61 datë 24.05.2012 për "*Akcizat në Republikën e Shqipërisë* “ i ndryshuar, gjatë kryerjes kryerjes së detyrave funksionale doganore në lidhje me mbikëqyrjen e regjimeve doganore dhe kryerjes së detyrave funksionale doganore gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë së subjekteve që operojnë sipas ligjit të Akcizës në RSH sipas rasteve të konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit

5. Për z. A.H., me detyrë doganier i sektorit të regjimeve dhe akcizës.

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2 prot DPD, datë 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 61 datë 24.05.2012 për "*Akcizat në Republikën e Shqipërisë* “ i ndryshuar, gjatë kryerjes kryerjes së detyrave funksionale doganore në lidhje me mbikëqyrjen e regjimeve doganore dhe kryerjes së detyrave funksionale doganore gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë së subjekteve që operojnë sipas ligjit të Akcizës në RSH sipas rasteve të konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit -për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore*”, nxjerrë për këtë qëllim që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave të për të cilat dalin të dhëna të përditësuara të bursës nga Departamenti Teknik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

6. Për z. A.T., me detyrë doganier i sektorit të regjimeve dhe akcizës.

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2 prot DPD, datë 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 61 datë 24.05.2012 për "*Akcizat në Republikën e Shqipërisë* “ i ndryshuar, gjatë kryerjes kryerjes së detyrave funksionale doganore në lidhje me mbikëqyrjen e regjimeve doganore dhe kryerjes së detyrave funksionale doganore gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë së subjekteve që operojnë sipas ligjit të Akcizës në RSH sipas rasteve të konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit -për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore*”, nxjerrë për këtë qëllim që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave të për të cilat dalin të dhëna të përditësuara të bursës nga Departamenti Teknik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

II.a. Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, për punonjësin e larguar nga Shërbimi Doganor në Republikën e Shqipërisë sipas përcaktimeve të Nenit 58

germa “ç”, i cili rekomandohet të klasifikohet në nivelin e masës “Largim nga shërbimi civil”,

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2 prot DPD, datë 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 61 datë 24.05.2012 për "Akcizat në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar, gjatë kryerjes kryerjes së detyrave funksionale doganore në lidhje veprimtarinë e tij gjatë nxjerrjes së vendimeve administrative sipas rasteve të konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, të njoftojë Departamentin e Administratës Publike si dhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për rekomandimin e KLSH-së për punonjësin e mëposhtëm:

1. z. E.P., me detyrë ish Kryetar i Degës Doganore Berat.

II.-b Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, për punonjësin e larguar nga Shërbimi Doganor në Republikën e Shqipërisë sipas përcaktimeve të Nenit 58 germa “ç”, i cili rekomandohet të klasifikohet në nivelin e masës “Largim nga shërbimi civil”,

- për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara nëni 14 pika 7 dhe 7.1 e Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me shkresën nr. 19095/2 prot DPD, datë 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar sipas rasteve të konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit për veprime jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 432, datë 28.06.2006 të MF “Për krijimin e të ardhurave dytësore që krijojnë Institucionet Buxhetore”, shkresës nr. 13119, datë 02.11.2006, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Mbi caktimin e tarifave të të ardhurave dytësore në Administratën Doganore, Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 432, datë 28.06.200 “Për nxjerrjen e të ardhurave dytësore”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, të njoftojë Departamentin e Administratës Publike si dhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për rekomandimin e KLSH-së për punonjësin e mëposhtëm:

1. znj E.Q., me detyrë ish përgjegjëse e financës të Degës Doganore Berat.

III. Nga analiza e të metave dhe mangësive të konstatuara dhe të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për punonjësit: z. A. B. (larguar), znj. G. B. (pezulluar), z. L. Nj. (larguar), z. E. B.; z. E. K.; z. A. A.; z. M. P. dhe z. A. Sh., (pezulluar) është menduar të mos rekomandohet masë disiplinore, pasi mospërmbushja e detyrave prej tyre nuk është në nivelin e përgjegjësisë për fillimin e ecurisë disiplinore.

Me ndjekjen dhe zbatimin e masave të rekomanduara me këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R